



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:092760

Datë: 20.09.2024

Numri i dokumentit: 06231643

KA.nr.583/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Ipko Telecommunications LLC me seli në Prishtinë adresa rruga “Zija Shemsiu” numër 34, përfaqësuar sipas autorizimit nga avokat Z. Isamedin Dedinca nga Prishtina kundër të paditurve 1. Organi Shqyrtues i Prokurimit (tutje referuar OSHP) me seli në Prishtinë përfaqësuar sipas autorizimit nga Znj. Erëlehta Popaj, 2. K.R. “Pastrimi”, me seli në Prishtinë përfaqësuar sipas autorizimit nga Znj. Agnesa Dugolli Halilaj, për shkak të anulimit të vendimit PSH.nr. 373/20 i datës 08.07.2020 pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik më datë 09.09.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit me autorizim të palës paditëse dhe të përfaqësuesve me autorizim të palëve së paditura, më datë 20.09.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET në tërësi** kërkesëpadia e paditësit Ipko Telecommunications LLC me seli në Prishtinë kundër të paditurve 1. Organi Shqyrtues i Prokurimit (tutje referuar OSHP) me seli në Prishtinë, 2. K.R. “Pastrimi”, me seli në Prishtinë për shkak të anulimit të vendimit PSH.nr. 373/20 i datës 08.07.2020, me propozim që të detyrohet e paditura e dytë K.R. “Pastrimi” SH.A. me seli në Prishtinë që paditësit IPKO Telecommunications LLC t’ia kompensoj fitimin e humbur në shumë prej 3,989.73 euro me kamat ligjore prej 8% në vit, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë në Gjykatë e deri në pagesën definitive në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, **si e pa bazuar**.
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## A r s y e t i m

### Historiku procedural

1. Më datë 06.08.2020, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, paditësi Ipko Telecommunications LLC me seli në Prishtinë ka parashtruar padi e evidentuar me nr. A.1309/20, kundër të paditurve 1. Organi Shqyrtues i Prokurimit (tutje referuar OSHP) me seli në Prishtinë, 2. K.R. “Pastrimi”, me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit PSH.nr. 373/20 i datës 08.07.2020, me propozim që anulohet i sipërshtënuar si i kundërligjshëm, të detyrohet e paditura e dytë K.R. “Pastrimi” SH.A. me seli në Prishtinë që paditësit IPKO Telecommunications LLC t’ia kompensoj fitimin e humbur në shumë prej 3,989.73 euro që i është shkaktuar, i precizuar pas nxjerrjes së ekspertizës financiare me kamat ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data e parashtrimit të padisë në Gjykatë e deri në pagesën definitive në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Akgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.
2. Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA nr. 583/22.
3. Gjykata mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik më datë 05.06.2024 dhe më datë 09.09.2024 me pjesëmarrje të përfaqësuesit të palës Z.Isamedin Dedinca sipas autorizimit të datës 02.12.2019, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të palës së paditurës së parë Znj.Erëlehta Popaj sipas autorizimit të datës 06.03.2024, me pjesëmarrje të paditurës së dytë Znj.Agnesa Dugolli Halilaj, sipas autorizimit të datës 31.05.2024 dhe me pjesëmarrje të ekspertit financiar Z. B.L..

### Pretendimet e paditësit

4. Përfaqësuesi i paditësit në pretendimet e dhëna në padi, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se më datë 26.05.2020 Autoriteti Kontraktues K.Regjionale e Mbeturinave Pastrimi Sh.a. (tutje referuar si AK), ka

publikuar njoftimin për kontratë me titull “ Shërbimi me internet dhe VPN”, me numër të prokurimit 20-2213-2-3-6 me numër të brendshëm Pas 20 020 236, ashtu që paditësi si operator ekonomik (tutje referuar OE), ka shprehur interesim duke konkuruar në këtë aktivitet të prokurimit për kryerjen e shërbimeve. Më datë 10.06.2020 OE Telekom i Kosovës Sh.a , ka paraqitur ankesë te e paditura e parë OSHP kundër njoftimit për dhënie të kontratës me titull “Shërbimi me internet dhe VPN”, me numër të prokurimit 20-2213-2-3-6 me numër të brendshëm pas 20 020 236, të iniciuar nga ka “Pastrimi Sha”, si e paditur e dytë me pretendimin e AK ka bërë shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik (tutje LPP), përkatësisht të dispozitave ligjore të nenit 9 par. 4, tuje si rrjedhojë OSHP ka pranuar ankesën e OE “Telekomi i Kosovës” Sha duke autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar pretendimet e Telekomit të Kosovës Sha i cili i ka propozuar panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues “Telekomi i Kosovës” Sha, të aprovohet si e bazuar dhe ky aktivitet i prokurimit të anulohet.

5. Sipas tij i padituri i parë duke vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së nxjerr vendimin e tani të kundërshtuar me padi me nr. 373/20 të datës 08.07.2020 me të cilin e aprovon ankesën e “Telekomit të Kosovës” Sha, duke e anuluar njoftimin për dhënie të kontratës, ndërsa si pasojë e këtij vendimi AK pa aplikuar fare dispozitat e procedurës së prokurimit lidhë kontratë me Telekomin e Kosovës Sh.a., me titull Shërbimi me internet dhe VPN”, me numër të prokurimit 20-2213-2-3-6 me numër të brendshëm 20 020 236, me çka paditësit i mohohet e drejta që të konkurroj si OE për ofrimin e këtyre shërbimeve, duke i shkaktuar dëm i konsiderueshëm material.
6. Ka shtuar se i padituri AK gabimisht e ka kualifikuar OE “Telekomi i Kosovës”, Sha, si autoritet publik duke interpretuar dispozitat ligjore të LPP-së përkatësisht nenit 4 par. 1.44 të LPP-së në mënyrë të gabuar pastaj duke interpretuar gabimisht edhe nenin 9.4 të LPP-së, pasi që autoritetet publike janë ministritë, agjencitë, komunat dhe organet tjera të cilat plotësojnë kriteret e paraqitura si autoritete publike, ndërkaq Telekom i Kosovës Sh.a, është ndërmarrje publike sipas ligjit në fuqi në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe si ndërmarrje publike në rastet kur blen shërbime dhe mallra paraqitet si AK dhe duhet të respektoj LPP-në në çfarëdo blerje, ngase konsiderohet si OE i barabartë me të gjithë OE-të tjerë në vend, ngase roli dyfishtë i Telekomit të Kosovës në aspektin e prokurimit duhet të përcaktohet varësisht a paraqitet si ndërmarrje publike apo si furnitor. Telekom i Kosovës Sh.a , nuk është autoritet publik por është ndërmarrje

publike që e ka licencën për ofrimin e shërbimeve të telekomunikacionit në Tregun e Republikës së Kosovës po aq s ka edhe operatori IPKO Telecommunications LLC, ndërsa në aktivitetin e prokurimit në fjalë Telekom i Kosovës Sha nuk ka marr pjesë. Në seancën e datës 05.06.2024 gjykatës i ka propozuar që të caktoj një ekspertizë financiare për llogaritjen e fitimit të humbur, si dhe duke i propozuar që të që anulohet i sipërshënuar si i kundërligjshëm, të detyrohet e paditura e dytë K.R. “Pastrimi” SH.A. me seli në Prishtinë që paditësit IPKO Telecommunications LLC t’ia kompensoj dëmin që i është shkaktuar i precizuar pas nxjerrjes së ekspertizës financiare me kamat ligjore prej 8% në vit duke filluar nga data e parashtrimit të padisë në Gjykatë e deri në pagesën definitive në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

#### Kundërshtimet e të paditurës së parë OSHP

7. Përfaqësuesi i të paditurës në pretendimet e dhëna në përgjigje në padi sipas parashtresës së datës 08.04.2024, gjatë seancës së shqyrtimit kryesor si dhe një fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton kërkesëpadinë e paditësit për faktin se vendimi është marrë bazuar në nenin 9.4 të LPP-së pasi që Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik ka lëshuar një interpretim në lidhje me pretendimin e OE ankues për mosrespektim të nenit 9.4 të LPP-së duke sqaruar se “ Nëse AK është autoritet publik autoriteti i tillë duhet të marr masa të arsyeshme për tu siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë AK tjetër publik”, që është e qartë se në këto raste ka të bëjë me përjashtimet nga legjislacioni i LPP-së kur një formë e partneritetit publiko-privat realizohet në atë se një AK mund të kërkoj ofrimin e një shërbimi në shërbimet e tij, ose shërbimeve të një autoriteti tjetër kontraktues pa iniciuar ndonjë procedurë tjetër të tenderimit, të ashtuquajtura përjashtim “ blejë në shtëpi”. Vendimi i kundërshtuar me padi është i bazuar në një vendim i Qeverisë ne. 05/21 të datës 02.04.2020 vendime që përjashton LPP-në për shërbimet tel komunikuese që ofron Telekom i Kosovës Sh.a, si shërbime me rendësi të veçantë shtetërore. Për këtë arsye OSHP e ka anuluar njoftimin për kontratë të AK- duke e aprovuar si të bazuar ankesën e OE Telekom i Kosovës Sh.a. Andaj i ka propozuar gjykatës që padinë paditësit t’a refuzoj si të pabazuar.

#### Kundërshtimet e të paditurës së dytë KR. “Pastrimi” Sh.a

8. Përfaqësuesi i të paditurës së dytë në pretendimet e dhëna përmes përgjigjes në padi të datës sipas parashtrësës së datës 03.04.2024, deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor si dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se kërkesëpapia e paditësit është në tërësi si e pa bazuar për faktin se pretendimi i paditësit se e paditura me njoftimin për anulimin e kontratës së aktivitetit të prokurimit me titull “Shërbimi me internet dhe VPN”, me numër të prokurimit 20-2213-2-3-6 me numër të brendshëm pas 20 020 236, të iniciuar nga AK “Pastrimi Sha”, është në kundërshtim e nenin 9 par. 4 të LPP-së nuk qëndron për faktin se anulimi i këtij njoftimi është bërë në kundërshtim me procedurave ligjore.
9. Ka shtuar se e paditura OSHP me rastin e zhvillimit të procedurës së prokurimit nuk ka bërë shkelje të nenin 9.3 të LPP-së pasi që paditësi IPKO nuk e ka statusin e autoritetit publik sipas nenit 1.44 të Ligjit për Prokurimin Publik i cili i përcakton autoritetet publike. Sa i përket pretendimit të paditësit për fitimin e humbur i njëjti ka theksuar se paditësi nuk mund të konsiderohet palë e dëmtuar në rastin konkret pasi që procedura e KA-së është zhvilluar konform procedurave ligjore. Gjykatës i ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar kërkesëpapia e paditësit IPKO Telecommunications LLC

#### Provat e administruara

10. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Dosja e tenderit me nr.prok:20-2213-2-3-6 me datë 26.05.2020 me titull “Shërbimi me internet dhe VFN, Njoftimi për kontratë me datë 26.05.2020, Vendimi i kundërshtuar PSH.Nr.373/20 me datë 08.07.2020, Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, Ankesë nga ankuesi i Telekomit Sh.a me nr.373/20 i datës 11.06.2020, Raporti i ekspertit shqyrtues H.M. me datë 23.06.2020, Vendim i AK me datë 06.03.2020, Ekspertiza Financiare e ekspertit shqyrtues, B.L. e datës 16.08.2024.
11. Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenit 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, deklarimet e përfaqësuesit të paditësit në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpapia e paditësit është e pa bazuar.

12. Nga Dosja e tenderit me nr.prok:20-2213-2-3-6 me datë 26.05.2020 me titull “Shërbimi me internet dhe VFN, AK K. Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.a., ka njoftuar OE-të e interesuar për aplikim në aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbimi me Internet VPN”, numri i prokurimit 20-2213-2-3-6 numri i brendshëm PAS 20 020 236, lidhur me pjesët e dosjes së tenderit dhe anekset e saj, kërkesat specififikimet, duke i njoftuar se kuotimi i çmimit duhet të dorëzohet para datës 05.06.2020.
13. Nga Njoftimi për kontratë me datë 26.05.2020, AK “ K. Regjionale e Mbeturinave”, “ Pastrimi” SH.A., ka njoftuar operatorët ekonomik të interesuar për pjesëmarrje në këtë lloj të aktivitetit të prokurimit, duke i përcaktuar titullin e kontratës “Shërbimi me Internet VPN”, numri i prokurimit 20-2213-2-3-6 numri i brendshëm PAS 20 020 236 duke i përcaktuar kushtet e pjesëmarrjes, kriteret për dhënie të kontratës si çmimi më i ulët, afati i fundit i pranimit të tenderëve është përcaktuar data 05.06.2020.
14. Me datë 03.06.2020 AK ka refuzuar ankesën e OE Telekomit. ndaj njoftimit për dhenje të kontratës OE IPKO, si të pabazuar. Ndaj këtoj vendimi ankuesi i Telekomit Sh.A ka parashtruar ankese në OSHP me nr.373/20 i datës 11.06.2020.
15. Në procedurë pranë OSHP-së, para shqyrtimit të ankesës nga , Paneli Shqyrtues i OSHP-së, Eksperti shqyrtues H.M. ne ekspertizën e prokurimit te datës 23.06.2020, ka theksuar se KRPP ka ofruar interpretim ligjor në atë se neni 9 par. 4 i LPP-së kërkon nga autoritetet kontraktuese që të veprojnë si në vijim “ Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marr masa të arsyeshme për tu siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik”, pra ky nen i rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues si autoritet publik ka nevojë për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik. LPP nuk e sqaron më tej se si autoritetet publike do të rregullojnë plotësimin e nevojave të tyre meqë kjo është çështje e autoriteteve publike dhe /ose rregullave të tjera. Meqë nuk ka asnjë dispozitë tjetër të LPP-së e cila i obligon Autoritetet Publike që të marrin masa për të mos lejuar “shtrembërimin e konkurrencës” (sikur ato nga direktiva e BE-së neni 12.1) KRPP nuk ka si të trajtoj këtë çështje ashtu sikur është vendosur në nenin 9.4 të LPP-së. I ka propozuar panelit shqyrtues të prokurimit që ankesa e OE ankues në rastin

konkret të “Telekomi” Sh.a, të aprovohet si e bazuar dhe ky aktivitet i prokurimit të anulohet.

16. Paneli Shqyrtues i OSHP-së me Vendimin e kundërshtuar PSH.Nr.373/20 me datë 08.07.2020 në pikën I të vendimin e ka aprovuar si të bazuar ankesën e OE “Telekomi i Kosovës” Sh.a., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “ Shërbime me Internet dhe VPN”, me nr. të prokurimit 20-2213-2-3-6 iniciuar nga AK “Pastrimi” SHA, ndërsa në pikën II të këtij vendimi e ka anuluar njoftimin për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbime me internet dhe VPN”, me nr. të prokurimit 20-2213-2-3-6, iniciuar nga AK “Pastrimi” SHA.. Paneli shqyrtues me rastin e vendimmarrjes lidhur me ankesën e OE ankues për aktivitetin e prokurimit është bazuar në vendimin e Qeverisë Nr./ 05/21 të datës 02.04.2020 vendim që përjashton LPP-në për shërbimet telekomunikuese që ofron “Telekomi i Kosovës” SH.A., si shërbime me rëndësi të veçantë shtetëroresi si dhe në interpretimin e Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik (tutje referuar si KRPP) në lidhje me pretendimin e OE ankues për mos respektim të nenit 9.4 të LPP-së nga Autoritetet Kontraktuese ku ka sqaruar se “Nëse një AK është autoritet publik autoriteti i tillë duhet të marr masa të arsyeshme për tu siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik”, ky nen i rregullon rastet kur Autoriteti Kontraktues si autoritet publik ka nevojë për sigurimin e shërbimeve operator i të cilave po ashtu është një autoritet publik, LPP nuk e sqaron më tej se si autoritetet publike do të rregullojnë plotësimin e nevojave të tyre (në mes vete), meqë kjo është çështje e autoriteteve publike dhe/ose rregullave tjera.
17. Më datë 14.07.2020 AK K. Regjionale e mbeturinave “Pastrimi” Sha ka njoftuar mbi anulimin e aktivitet të prokurimit me titull “ Shërbime me Internet dhe VPN”, me nr. të prokurimit 20-2213-2-3-6 iniciuar nga AK “Pastrimi” SHA, ku ka përcaktuar se arsyeja e anulimit të procedurës së prokurimit një dispozitë ligjore e Ligjit për Prokurimin Publik. Ndaj këtij njoftimi “Telekomit” Sh.a me nr.373/20 i datës 11.06.2020, ka parashtruar ankesë sa i përket tenderit “Shërbimi me internet dhe VPN “ numri i prokurimit vetë financim 20-2213-2-3-6.
18. Nga Ekspertiza Financiare e ekspertit shqyrtues B.L. e datës 16.08.2024, eksperti shqyrtues ka konstatuar se bazuar në metodën e marzhës së kontributit dhe shpenzimeve e pagave bruto dhe shpenzimet e përgjithshme operationale i atribuohen kostos së

produktit, ndërsa shpenzimet e amortizimit dhe zhvlerësimit duke e marrë parasysh që këto të hyra përfaqësojnë vetëm 0.008% të qarkullimit ekonomik, konsiderohen si shpenzime të periudhës dhe nuk zbriten nga fitimi i humbur, ndërsa vlera e fitimit të humbur është në shumë prej 2,563.33 euro, ndërsa në seancë ka deklaruar se nëse hiqen pagat dhe shpenzimet e përgjithshme vlera e fitimit të humbur është 3,989.73 euro.

### Vlerësimi i gjykatës

19. Pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të paditësit në seancë, deklaramëve në padi nga paditësi, si dhe në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së, dhe gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.
20. Gjykata vlerëson se me vendimin e kundërshtuar me padi PSH.nr. 373/20 të datës 08.07.2020 nga paneli shqyrtues i prokurimit është anuluar njoftimi për kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbime me internet dhe VPN”, me nr. të prokurimit 20-2213-2-3-6, iniciuar nga AK “Pastrimi” SHA., të cilin vendim paneli shqyrtues e kishte mbështetur në dispozitën e nenit 9 paragrafi 4 të LPP-së i cili përcakton se *“Nëse autoriteti kontraktues është autoritet publik, autoriteti i tillë publik duhet të marrë masa të arsyeshme për t’u siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik”*, duke arsyetuar faktin se Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik ka lëshuar një interpretim ku ka sqaruar se *“Nëse një AK është autoritet publik autoriteti i tillë duhet të marr masa të arsyeshme për tu siguruar se lëndët që i përmbushin këto nevoja nuk janë në dispozicion nga ndonjë autoritet tjetër publik”*. Paneli shqyrtues i OSHP-së i është referuar vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 05/21 të datës 02.04.2020, përmes të cilit vendim është përjashtuar nga fushëveprimi i Ligjit për Prokurimin Publik “Telekomi i Kosovës” Sha, për shërbimet telekomunikuese që i ofron në harmoni me nenin 3.1 dhe 9.4 të ligjit nr. 04/L-0422 për Prokurimin Publik .
21. Gjykata sqaron se paneli shqyrtues i prokurimit gjatë nxjerrjes së vendimit të kundërshtuar me padi PSH.nr. 373/20 të datës 08.07.2020 ka vepruar sipas vendimit nr. 05/21 të datës 02.04.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me të cilin “Telekomi i Kosovës” është përjashtuar nga procedura e prokurimit, andaj vlerëson se bazuar në



nenin 3 par. 1 të LPP-së në të cilin citohet se *“Pavarësisht nga dispozitat e tjera të këtij ligji, autoriteti kontraktues nuk do të kërkohet që të veprojë në përputhje me ndonjë procedurë të veçantë të prokurimit apo të respektoj dispozitat e këtij ligji mbi transparencën gjer në shkallën kur, përputhshmëria dhe respektimi do të kompromitonin sekretin e ligjshëm ose interesat e sigurisë gjatë kryerjes së aktiviteteve të prokurimit të rëndësishme për dhënien e një kontrate publike për të cilën Qeveria është pajtuar që ta përjashtojë nga fushëveprimi i këtij ligji sepse (i) ekzekutimi i kontratës në fjalë, sipas ligjit të aplikueshëm në Kosovë, kërkon përdorimin e masave të veçanta të sigurisë, ose (ii) Qeveria është pajtuar që ta klasifikojë lëndën e kontratës në fjalë si sekret.*

22. Gjykata vlerëson se paditësi përmes padisë ka kërkuar anulimin e vendimit të OSHP-së dhe nuk kë kërkuar vlerësimin e ligjshmërisë të vendimit të Qeverisë me nr. 05/21 të datës 02.04.2020, në bazë të cilin është nxjerr vendimi, i cilë ka qenë në fuqi në kohën e marrjes së vendimit të kundërshtuar i OSHP-së, prandaj gjykata nuk u lëshuar në vlerësimin e ligjshmërisë së këtij vendim, në bazë të cilit është marrë vendimi i kundërshtuar me padi. Vendimi i Qeverisë me nr. 05/21 të datës 02.04.2020, është shfuqizuar me Vendimin Nr. 05/34 të datës 07.10.2020. Sipas, **Neni 5 të Ligji Nr. 05/L-031** për Procedurën e Përgjithshme Administrative, 1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj. 2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja në të kaluarën (retroaktive), ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm në të ardhmen. Anulimi edhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm.
23. Prandaj gjykata vlerëson se në kohën e marrjes se Vendimit të kundërshtuar PSH.Nr.373/20 me datë 08.07.2020 nga Paneli Shqyrtues i OSHP-së, ishte në fuqi Vendimi i Qeverisë me nr. 05/21 të datës 02.04.2020, ligjshmëria e të cilit nuk është kontestuar. Duke pas parasysh që Vendimi 05/21 të datës 02.04.2020 ishte shfuqizuar me Vendimin Nr. 05/34 të datës 07.10.2020, deri ne momentin e shfuqizimit i njëjti ka krijuar pasoja juridike, te cilat ndërprerën vetëm pas shfuqizimit, prandaj konsiderohet se vendimi i kundërshtuar PSH.Nr.373/20 me datë 08.07.2020 nga Paneli Shqyrtues i OSHP është marrë në bazë të një aktit në ligjor të vlefshëm në kohën e zbatimit.

24. Kërkesa e paditësit për kompensim të fitimit të humbur për mos dhënie të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, është e pabazuar në kuptim të nenit 46. paragrafi 4 të LKA-së ku përcaktohet *se kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendosë për çështjen administrative, sepse ne këtë rast nuk u anulua akti administrativ i kundërshtuar.*
25. Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Vendimi për shpenzime procedurale shpenzimet procedurale u more në bazë të nenit 64 të LKA-së

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.583/22, datë 20.09.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.